



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME BUJQËSORE “RAKIP KRYEZIU” FIER

Nr. 255 prot.

Fier, më 10.09.2026

Lenda: Njoftim për levizje paralele

DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
TIRANË

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019 “Për nxitjen e Punësimit”, Ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshilli të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, Udhëzimit nr. 759 date 30.09.2024, Udhëzimit nr 4 dt 18.08.2025

“PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE VEPRIMTARISË, MENAXHIMIN E BURIMEVE NJERËZORE, PËRBËRJEN E NJËSISË SË ZHVILLIMIT TE INSTITUCIONEVE, OFRUESVE TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL DHE ZHVILLIMIT TË VAZHDUAR PROFESIONAL TË PERSONELIT ”

Ju njoftojme për krijimin e **1 (nje) vendi të lire për pozicionin:**

- Mësues i teorisë dhe praktikës profesionale në kualifikimin **Bujqësi, me orë**

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti për mësimdhënës të kulturës profesionale duhet të përmbushë këto kriteret:

1.1 Kriteret të përgjithshme:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit.

1.2. Kriteret të posaçme:

- a) të ketë diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlershme, në fushën e Bujqësisë
- b) të ketë të paktën 1 (një) vitë përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;

- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;
2. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) letërmotivimin për pozicionin;
- b) jetëshkrimin (CV-në) sipas modelit Europass,
- c) kartën e identitetit;
- d) diplomën e studimeve universitare ;
- e) librezën e punës;
- f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- g) certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h) vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- i) vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- j) vërtetimin nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
- k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara.

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në sekretarinë e shkollës, brenda datës

18.09.2026

3. Vlerësimi i kandidatëve do bëhet referuar përcaktimeve të udhëzimit nr 759, dt 27.05.2024 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimit e burimeve njerëzore, përberjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar të personelit”, i ndryshuar.

